



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2024:080121

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05753667

KA.nr.133/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ të paditësit “Telekomi i Kosovës” Sh. A me seli në lagjen Dardania në Prishtinë, kundër të paditurës Republika e Kosovës, Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Organi i shkallës së Dytë i Inspektoratit të Punës me seli në Prishtinë, me objekt të konfliktit administrativ anulimi i aktit administrativ, jashtë seancës, më 30 maj 2024 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

Konsiderohet e tërhequr padia e paditësit “Telekomi i Kosovës” Sh. A me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Republika e Kosovës, Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Organi i shkallës së Dytë i Inspektoratit të Punës me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit të shkallës së dytë me numër IP. Nr. 24/2024 i datës 02.02.2024 dhe i shkallës së parë nr.01/56-280/2023-GJ i datës 25.09.2023.

**A R S Y E T I M**

Paditësi më 12.03.2024 ka paraqitur padi kundër të Paditurit, me të cilën kishte kërkuar anulimin e vendimit të shkallës së dytë me numër IP. Nr. 24/2024 i datës 02.02.2024 dhe i shkallës së parë nr.01/56-280/2023-GJ i datës 25.09.2023 të së paditurit Republika e Kosovës, Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Organi i shkallës së Dytë i Inspektoratit të Punës me seli në Prishtinë. Meqenëse paditësi nuk kishte bashkëngjitur padisë vërtetimin mbi pagesën e taksës gjyqësore, kjo gjykatë më datë 13.03.2024 paditësit ia ka dorëzuar vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore, ndërsa i njëjti e ka pranuar vërejtjen me datën 15.03.2024. Përmes asaj vërejtjeje Paditësi është paralajmëruar se nëse nuk paguhet taksa gjyqësore brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e pranimit, atëherë gjykata do të veproj sipas

nenit 253 para. 5 të LPK-së dhe nenit 5 lidhur me nenin 6 të Udhëzimit Administrativ 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore të Këshillit Gjyqësor.

Në bazë të shkresave të lëndës gjykata konstaton se, Paditësi jo që nuk e ka paguar taksën gjyqësore brenda afatit të caktuar prej 15 ditëve, por ajo nuk është paguar as deri në ditën e marrjes së këtij aktvendimi. Kjo gjykatë gjithashtu gjeti se në shkresat e lëndës nuk ka prova, në bazë të cilave do të mund të konstatohej se plotësohen kushtet ligjore nga nenet 468 deri 473 të LPK-së për lirimin e Paditësit nga shpenzimet procedurale.

Pasojat juridike të mos pagesës së taksës gjyqësore janë të rregulluara në nenin 253 para. 5 të LPK-së, sipas të cilit *“Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr”*. Gjithashtu edhe neni 5 para. 5 nënpara 2 të Udhëzimit Administrativ 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore të Këshillit Gjyqësore ka përcaktuar se *“Pala duhet ta paguajë taksën në afatin e caktuar nga gjykatësi, gjegjësisht kryetari i trupit gjykues, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 dite. Nëse kjo taksë nuk paguhet në kohën e caktuar, gjykata zbaton procedurat e parapara, si ne vijim: (...) 5.5.2 Nëse taksa për padi, e përcaktuar sipas vlerës së kontestit në padi, nuk paguhet deri në datën përfundimtare, edhe pas pranimit të vërejtjes për pagesën e saj, në rastet kur nuk ekzistojnë kushtet për lirimin e palës nga detyrimi i pagesës, do të zbatohet neni 253 paragrafi 5 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, ashtu që do të konstatohet se padia është tërhequr*.

Për këto arsye, gjykata e konsideron të tërhequr padinë e Paditësve dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimit.

Gjykata Komerciale e Kosovës

Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.133/24

Gjyqtari

---

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar

Numri i lëndës: 2024:080121  
Datë: 30.05.2024  
Numri i dokumentit: 05753667

dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.